




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Prishtinë, 2017



Përmbajtja:

| | |
|---|----|
| Hyrje | 3 |
| Njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe të komiteteve | 4 |
| Mbledhjet e hapura të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe të komiteteve | 4 |
| Mbledhjet e Kuvendit transmetohen direkt për qytetarët nëpërmjet “livestream” | 4 |
| Përgatitja e informatave pas përfundimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës | 5 |
| Publikimi i procesverbaleve të Kuvendit të Komunës dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa | 5 |
| Publikimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës | 5 |
| Dëgjimet publike buxhetore | 5 |
| Takimet me qytetarë | 6 |
| Konsultimi i publikut para miratimit të akteve | 6 |
| Qasja në dokumente publike | 6 |
| Parashtrimi i kërkesës së qytetarëve për Qasje në dokumente zyrtare e digjitalizuar | 7 |
| Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë | 7 |
| Përditësimi me informata i ueb-faqes zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe platformës -Prishtinaonline | 7 |
| Prokurimi transparent | 7 |
| Transparencë e plotë në punësim | 8 |
| Hapja e të dhënave në dispozicion të qytetarëve – OPEN DATA | 8 |
| Aplikacioni mobil - E-shpenzimet | 8 |
| Njoftimi i qytetarëve nëpërmjet mesazheve telefonike | 9 |
| Infografikat | 9 |
| Faqet zyrtare të Komunës së Prishtinës në rrjetet sociale | 9 |
| Qasje e shpejtë dhe transparente e qytetarëve në shërbimet digjitale | 9 |
| Platforma digjitale për participim të publikut (qytetarëve) | 10 |
| Qytetari aktiv - E-inspeksioni | 10 |
| Transparenca në Kulturë | 10 |


HYRJE

Hapja e Komunës për qytetarë e lehtëson transparencën e qeverisjes në Komunën e Prishtinës, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes.

Ne, në Komunën e Prishtinës, transparencën komunale e quajmë dimension jetik të qeverisjes lokale, në mënyrë që ajo të bëhet ashtu siç duan ta kenë qytetarët e Prishtinës, me qëllim që t'i besojnë asaj një qeveri demokratike, të hapur, transparente, efektive dhe efikase.

Përmes politikave dhe masave të marra, Komuna po bën përpjekje për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike, ashtu që qytetarët ta rrisin besueshmërinë në qeverisjen lokale dhe besimin në atë se zëri i tyre dëgjohehet në Komunë.

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 pika d) nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008) dhe në zbatim të udhëzimit administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna dhe legjislacionin tjetër në fuqi, Kryetari i Komunës së Prishtinës, propozon këtë Plan të Veprimit për Transparencë të Komunës i cili përmban 24 objektiva.



Objektivat e planit të veprimit

1. Njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe të komiteteve

Lidhur me njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, Komuna e Prishtinës i njofton qytetarët 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, siç është e përcaktuar në nenin 3, pika 3 dhe 4 e Udhëzimit administrativ nr. 01/2015, për transparencë në komuna.

2. Mbledhjet e hapura të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe komiteteve

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve janë të hapura për publikun, për zyrtarët monitorues të OJQ-ve që e përcjellin punën e Kuvendit, si dhe për subjektet e caktuara, të cilat janë objekt i diskutimit të ndonjë pike të rendit të ditës. Materiali i mbledhjeve të Kuvendit u dërgohet edhe zyrtarëve monitorues të OJQ-ve që e përcjellin punën e Kuvendit, por edhe të subjekteve të caktuara të cilat janë objekt i diskutimit në kohën e njëjtë me atë të asamblistëve, në mënyrë që të jenë të informuar saktë dhe korrekt për çdo gjë që do të diskutohet në atë mbledhje.

3. Mbledhjet e Kuvendit transmetohen direkt për qytetarët nëpërmjet “livestream”

Mbledhjet e Kuvendit transmetohen direkt për qytetarët nëpërmjet “livestream” të kanalit zyrtar të Komunës së Prishtinës në youtube, në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës si dhe shpërndarjes së tyre në faqet zyrtare të komunës në rrjetet sociale. Në kanalin e Komunës së Prishtinës në “youtube” dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, do të publikohet me kohë arkivi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

4. Përgatitja e informatave pas përfundimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës

Pas përfundimit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës, Zyra për informim është përgjegjëse ta përgatis lajmin rreth asaj se çka ka ndodhur në mbledhje, ballafaqimit të argumenteve pozitive-opozitive rreth pikave të caktuara të rendit të ditës, në mënyrë që qytetarët të jenë mirë të informuar. Lajmi publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, në platformën “Prishtinaonline”, në aplikacionin mobil “Prishtinadigjitale”, në faqet zyrtare të komunës në rrjetet sociale, si dhe dërgimi i e-mailit mediave të shkruara dhe elektronike.

5. Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa

Pas përfundimit të mbledhjeve, Shërbimi i kuvendit është e obliguar të shkruajë transkriptin e mbledhjeve dhe në bazë të tij të përgatis procesverbalin. Procesverbalet së pari duhet të votohen në Kuvendin e Komunës dhe Komitetin për Politikë dhe Financa. Pas kryerjes së kësaj procedure, publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe në platformën “Prishtinaonline”.

6. Publikimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës

Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit përkatës për qasje në dokumente publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Të gjitha këto akte publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe në platformën “Prishtinaonline”.

7. Dëgjimet publike buxhetore

Në muajin gusht të çdo viti, Komuna e Prishtinës organizon dëgjime publike buxhetore me qytetarë, për çdo fushë, në mënyrë që të përfshihen qytetarët në procesin e vendimmarrjes për hartimin e buxhetit të vitit pasues.

8. Takimet me qytetarë

Udhëzimi administrativ nr. 01/2015, për transparencë në komuna, neni 6, pika 1, e parasheh që Komuna çdo vit duhet të mbajë së paku dy takime publike me interes të përgjithshëm. Komuna e Prishtinës do ta vazhdojë praktikën e njëjtë si të viteve paraprake. Në shumicën e këtyre takimeve pjesëmarrës është edhe Kryetari i Komunës. Këto takime mbahen në lagje të ndryshme, për probleme të caktuara, për infrastrukturë, siguri, arsim, shëndetësi, shkolla, çerdhe, hapësira publike e shumë tema të tjera të rëndësishme. Njoftimet për këto takime publikohen së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, si dhe në platformën “Prishtinaonline”. Pas përfundimit të takimeve, Zyra për informim është përgjegjëse të përgatis lajm për këtë, ashtu që qytetarët të jenë të informuar për pikat të cilat janë diskutuar.

9. Konsultimi i publikut para miratimit të akteve

Komuna e Prishtinës organizon diskutime publike me qytetarë para miratimit të akteve që janë me interes për qytetarët. Rekomandimet e paraqitura nga ana e qytetarëve, shqyrtohen nga ana e ekspertëve të çështjes dhe pastaj ato rekomandime përfshihen në aktin, i cili dërgohet në Kuvend për miratim.

10. Qasja në dokumente publike

Për të qenë sa më transparent ndaj qytetarëve, Komuna e Prishtinës në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, në menynë “Qasja në dokumentet publike” i ka të publikuara informatat e personave kontaktues për qasje në dokumente zyrtare. Çdo qytetar ka të drejtë të bëjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Formulari i kërkesës për qasje në dokumente zyrtare është publike në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës. Formulari dorëzohet në zyrat e Qendrës për shërbim me qytetarë (QSHQ). Të gjitha kërkesat për dokumente zyrtare, personat përgjegjës të QSHQ-së ua dorëzojnë personave përgjegjës për procedimin e këtyre kërkesave për qasje në dokumente publike. Të gjitha kërkesat trajtohen në mënyrë të barabartë dhe shqyrtohen sipas afatit.

11. Parashtrimi i kërkesës së qytetarëve për Qasje në dokumente zyrtare e digjitalizuar

Qytetarët e Komunës së Prishtinës e kanë mundësinë që në mënyrë digjitale të parashtrojnë kërkesën për Qasje në dokumente zyrtare. Projekti është plotësisht i automatizuar dhe pas pregaditjes së dokumenteve të kërkuara, Komuna përmes e-mailit e informon qytetarin për të tërhequr dokumentin e kërkuar.

12. Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë

Kryetari mban takime me qytetarë sipas kërkesave të adresuara nga ana e qytetarëve. Çdo kërkesë e qytetarëve shqyrtohet dhe kontaktohet nëpërmjet telefonit për orarin e takimit, ose për zhvillimin e takimit me ndonjë person kyç të çështjes për të cilën ka bërë kërkesë.

13. Përditësimi me informata i ueb-faqes zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe platformës “Prishtinaonline”

Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës dhe platforma “Prishtinaonline” plotësohen çdo ditë me informata, sipas Udhëzimit administrativ (MAP) nr. 01/2015, për ueb-faqet e institucioneve publike. Këto informata përfshijnë: lajme rreth aktiviteteve ditore, njoftime për takime publike, konkurse, projekte kapitale, raporte financiare, informata të drejtorive, udhëzues për qytetarë etj.

14. Prokurimi transparent

Komuna e Prishtinës në ueb-faqen e saj zyrtare dhe në platformën “Prishtinaonline”, i publikon me kohë:

- Planin e prokurimit
- Njoftimet për kontrata,
- Njoftimet për dhënien e kontratave,
- Njoftimet për konkurs të projektimit,
- Njoftimet për anulim,
- Njoftimet për informata shtesë,
- Njoftimet për nënshkrimin e kontratës,
- si dhe njoftimet për anulimin e dhënies së kontratës.

Po ashtu, Komuna e Prishtinës për çështjet e prokurimit, ka marrëveshje bashkëpunimi me lëvizjen FOL.

15. Transparencë e plotë në punësim

Zyra e personelit është përgjegjëse për publikim në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, në objektin e komunës dhe në mediat e shkruara, të njoftimit për konkurs, të listës së ngushtë për testin me shkrim, të listës për intervistë me gojë, të vazhdimin të konkursit dhe të anulimit të konkursit.

E-rekrutimi është platformë që mundëson aplikim "online" për pozitat e lira në Komunë dhe përcjelljen e procesit të rekrutimit për aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe numrin e pikëve të arritura.

Për çdo konkurs që ka të bëjnë me Drejtorinë e Arsimit, intervistat janë të hapura për publikun dhe, në fund, databaza me kandidatët dhe pikët e fituara publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe në platformën “Prishtinaonline”.

16. Hapja e të dhënave në dispozicion të qytetarëve – OPEN DATA

Përmes platformës “online” të hapjes së të dhënave ose “open data”, që është në funksion të transparencës dhe zhvillimit lokal, do të bëhet vizualizimi i të gjitha informacioneve të mbledhura nga drejtoritë komunale, me qëllim që këto shënime të përdoren më tutje në funksion të transparencës së plotë në Komunë dhe në funksion të zhvillimit lokal. Këto të dhëna do të jenë më shumë statistikore, sepse ky është qëllimi i “open data”, në mënyrë që të përdoren nga akterët për analiza të mëtutjeshme.

17. Aplikacioni mobil – E-shpenzimet

Aplikacioni për telefoni mobile (IOS dhe ANDROID versionet). Aplikacioni i cili shkarkohet dhe instalohet në telefonat e mençur mobilë, i cili tregon për lajmet me të reja nga Komuna, shpenzimet e Komunës të ndara në 5 kategori buxhetore (subvencionet dhe transferet, shpenzimet kapitale, shpenzimet komunale, mallrat dhe shërbimet, pagat dhe mëditjet). Në cilëndo kategori që klikohet, aplikacioni pastaj pasqyron ndarjen e asaj kategorie (shpenzimet) sipas drejtorive. Pasqyrimet

janë në formë grafike dhe të prezantuara me vlera të shpenzimeve. Çdo lajm ose shpenzim që përditësohet në këtë aplikacion, ju dërgon notifikim në telefonat e mençur të gjithë atyre qytetarëve që e kanë të shkarkuar këtë aplikacion.

18. Njoftimi i qytetarëve nëpërmjet mesazheve telefonike

Sistem për dërgimin e mesazheve nga Komuna e Prishtinës për njoftimin e qytetarëve rreth çështjeve të caktuara.

19. Infografikat

Tabela informuese për Drejtorinë e Administratës, të Kadastrit, të Shërbimeve Publike dhe të Urbanizmit, e cila ofron të dhëna se ku duhet të drejtohen qytetarët, cilat dokumente u nevojiten për çdo lloj të vërtetimit ose dokumentit që lëshon Komuna. Tabelat informuese janë të shpërndara nëpër drejtoritë përkatëse. Broshurat po ashtu janë të publikuara edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës, si dhe në “Prishtinaonline”, në mënyrë që të rritet sa më shumë transparenca me qytetarë. Tabelat informuese nëpër drejtoritë përkatëse e zvogëlojnë mundësinë e korrupsionit, për shkak se çdo qytetar saktë e di se ku duhet të drejtohet për marrjen e shërbimit të caktuar.

20. Faqet zyrtare të Komunës së Prishtinës në rrjetet sociale

Komuna e Prishtinës e ka të hapur faqen e saj zyrtare në “facebook”, “twitter” dhe “instagram”, ku i informon qytetarët për aktivitetet e Komunës.

21. Qasje e shpejtë dhe transparente e qytetarëve në shërbimet digjitale

Komuna e Prishtinës në qendër të vëmendjes e ka qytetarin dhe lehtësimin e qasjes së qytetarit në shërbimet që i ofron Komuna. Komuna i publikon në ueb-faqen zyrtare të gjitha informatat e nevojshme për qytetarë, në mënyrë që ai të pajiset me dokumente të caktuara. Janë publike: udhëzuesit, broshurat, si dhe platforma “Regjistrimi i procedurave administrative në Komunën e Prishtinës”, ku e informon qytetarin edhe për detajin më të vogël rreth pajisjes me një dokument të caktuar.

22. Platforma digjitale për participim të publikut (qytetarëve) – PrishtinaIme

Qëllimi i realizimit të kësaj platforme është përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Nëpërmjet kësaj platforme qytetarët mund t'i paraqesin kërkesat për lagjet e tyre. Kërkesat të cilat e arrijnë një numër të konsideruar të votave nga ana e lagjes, shqyrtohen nga Komuna për mundësinë e realizimit.

23. Qytetari aktiv – E-inspeksioni

Aplikacion mobil, nëpërmjet të cilit qytetari mund të paraqesë kërkesën e tij gjatë evidentimit të parregullsive ose mosrespektimit të ligjit nga ana e Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Inspeksionit pas pranimit të këtyre kërkesave nga ana e qytetarëve, merr masa të caktuara varësisht prej çështjeve.

24. Transparenca në Kulturë

Platformë e cila u mundëson institucioneve të pavarura kulturore të kryeqytetit, OJQ-ve, bizneseve, kompanive dhe individëve të aplikojnë “online” për subvencione, si dhe ta përcjellin të gjithë procesin e aplikimit.

25. Plani i transparencës do të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës.



| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës. |
|-----|--|---|--|---------------------------------------|--|
| 1 | Njoftimet për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe të komiteteve | <p>Njoftimet për mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ueb faqen zyrtare dhe platformën “Prishtinaonline” • Në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës • Në media të shkruara dhe elektronike • Rrjete sociale | Sekretaria e Kuvendit njofton zyrtarin për media për mbledhjen. Zyrtari për media e krijon njoftimin për qytetarë. | Salla e Kuvendit Komunal / Komiteteve | 7 ditë para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme |
| 2 | Mbledhjet e hapura të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe komiteteve | Mbledhjet janë të hapura për publikun, zyrtarët monitorues të OJQ-ve që e përcjellin punën e Kuvendit por edhe subjektet e caktuara që janë objekt diskutimi në ndonjë pikë të rendit të ditës | Sekretaria e Kuvendit i njofton për mbledhjen personat e caktuar si dhe ju bashkangjet dokumentet që do të diskutohen. | Salla e Kuvendit Komunal / Komiteteve | |
| 3 | Mbledhjet e Kuvendit transmetohen direkt për qytetarët nëpërmjet “livestream” | Mbledhjet e Kuvendit transmetohen direkt nëpërmjet kanalit zyrtar të Komunës së Prishtinës në youtube, në ueb-faqen zyrtare të Komunës si dhe nëpërmjet shpërndarjes së linkut në rrjetet sociale. | Zyra për Teknologji Informative | Salla e Kuvendit Komunal | Në ditët e mbajtjes së mbledhjes |
| 4 | Përgatitja e informatave pas përfundimit të mbledhjes së | Përgatitja e informatave pas çdo mbledhje të Kuvendit për mediat e shkruara dhe elektronike. Komunikata | Zyra për Informim | | Pas përfundimit të mbledhjes |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteve të organeve komunës. |
|-----|--|---|--|--|--|
| | Kuvendit të Komunës | publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, platformën “Prishtinaonline” si dhe në rrjetet sociale të Komunës së Prishtinës. | | | |
| 5 | Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa | Procesverbalet së pari votohen në Kuvendin e Komunës. Pas kryerjes së kësaj procedure, publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe platformën “Prishtinaonline”. | Procesverbalet shkruhen nga zyra e kuvendit, kurse publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe platformën “Prishtinaonline” nga zyrtarja e Teknologjisë Informative. | | Pas miratimit në Kuvendin Komunal |
| 6 | Publikimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës | Publikohen në ueb-faqet e komunës menjëherë pas 15 ditë nga dërgimi i tyre në MAPL. | Zyra e kuvendit aktet i përcjell tke zyrtarja për Teknologji Informative e cila i publikon pastaj në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe platformën “Prishtinaonline” | | |
| 7 | Dëgjimet publike buxhetore | Dëgjimet publike buxhetore mbahen me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes për hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm | Kabineti i kryetarit | Komuna e vjetër / e re e Komunës së Prishtinës | 2 javë para mbajtjes së takimit. |
| 8 | Takimet me qytetarë | Kryetari i Komunës së Prishtinës mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, si dhe | Zyra e Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku | Varësisht prej temave që diskutohen | Njoftimi 2 javë para mbajtjes |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteve të organeve komunës. |
|-----|---|--|---|--------------------------------|--|
| | | shumë takime të tjera për çështje të caktuara. | dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në ueb faqen zyrtare, platformën “Prishtinaonline”, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës, në media të shkruara dhe elektronike, rrjete sociale. | | |
| 9 | Konsultimi i publikut para miratimit të akteve | Komuna e Prishtinës organizon konsultime para miratimit të akteve që janë me interes për qytetarë. Rekomandimet e paraqitura nga ana e qytetarëve përfshihen në akt. | Sekretaria Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në ueb faqen zyrtare, platformën “Prishtinaonline” në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës, në media të shkruara dhe elektronike dhe në rrjete sociale | | Njoftimi 2 javë para mbajtjes |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës. |
|-----|---|---|--|----------------------------------|--|
| 10 | Qasja në dokumente publike | Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komuna e Prishtinës, bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organet e Komunës dhe i adreson ato në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. | Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike | | 7-15 ditë |
| 11 | Parashtrimi i kërkesës së qytetarëve për Qasje në dokumente zyrtare e digjitalizuar | Qytetarët mund të aplikojnë online për qasje në dokumente publike dhe me anë të email-it të njoftohen për tërheqjen e dokumentacionit të kërkuar. | Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike | | 7-15 ditë |
| 12 | Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë | Kryetari mban takime me qytetarë sipas kërkesave të adresuara nga ana e qytetarëve. | | | |
| 13 | Përditësimi me informata i web-faqes zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe platformës "Prishtinaonline" | Ueb faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës dhe platforma "Prishtinaonline" freskohet me lajme e informacione nga aktivitetet e përditshme të ekzekutivit dhe vendimmarrjes, si dhe materiale tjera publike sipas udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015. | Përgjegjëse për këtë është Zyra për Informim dhe Zyrarja për Teknologji Informative | | |
| 14 | Prokurimi transparent | Publikohen të gjitha njoftimet për kontrata, | Përgjegjës për publikim të tyre në | | Sipas afateve ligjore |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteve të organeve komunës. |
|-----|--|--|--|--------------------------------|--|
| | | njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimin për anulim, njoftimet për informata shtesë, si dhe njoftimet për anulimin e dhënies së kontratës. | ueb-faqe është Zyrtarja e Teknologjisë Informative. | | |
| 15 | Transparencë e plotë në punësim | Zyra e personelit është përgjegjëse për publikim në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës, platformën “Prishtinaonline”, në objektin e komunës dhe në mediat e shkruara, të njoftimit për konkurs, të listës së ngushtë për testin me shkrim, të listës për intervistë me gojë, të vazhimit të konkursit dhe të anulimit të konkursit. | Zyra e Personelit në bashkëpunim me Zyrtaren për Teknologji Informative | | Sipas afateve ligjore |
| 16 | Hapja e të dhënave në dispozicion të qytetarëve – OPEN DATA | Përmes platformës “online” të hapjes së të dhënave ose “open data”, që është në funksion të transparencës dhe zhvillimit lokal, do të bëhet vizualizimi i të gjitha informacioneve të mbledhura nga drejtoritë komunale, me qëllim që këto shënime të përdoren më tutje në funksion të transparencës së plotë në Komunë dhe në funksion të zhvillimit lokal. | Zyrtarja e Teknologjisë Informative | | |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteve të organeve komunës. |
|-----|---|--|--|--------------------------------|--|
| 17 | Aplikacioni mobil – E-shpenzimet | Aplikacioni i cili shkarkohet dhe instalohet në telefonat e mençur mobilë, i cili tregon për lajmet me të reja nga Komuna, shpenzimet e Komunës të ndara në 5 kategori buxhetore (subvencionet dhe transferet, shpenzimet kapitale, shpenzimet komunale, mallrat dhe shërbimet, pagat dhe mëditjet). | Njoftimet dërgohen nga zyra për media, shpenzimet e komunës nga Drejtoria e Financave, kurse publikimin e tyre në aplikacion e bën zyrtarja për Teknologji Informative | | |
| 18 | Njoftimi i qytetarëve nëpërmjet mesazheve telefonike | Sistem për dërgimin e mesazheve nga Komuna e Prishtinës për njoftimin e qytetarëve rreth çështjeve të caktuara. | Drejtoria e Administratës | | |
| 19 | Infografikat | Tabela informuese për Drejtorinë e Administratës, të Kadastrit, të Shërbimeve Publike dhe të Urbanizmit, e cila ofron të dhëna se ku duhet të drejtohen qytetarët, cilat dokumente u nevojiten për çdo lloj të vërtetimit ose dokumentit që lëshon Komuna. Të njëjtat janë publike edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe platformën “Prishtinaonline” | Drejtoria e Administratës | | |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteve të organeve komunës. |
|-----|---|---|--|--------------------------------|--|
| 20 | Shfrytëzimi i rrjeteve sociale | Të gjitha aktivitetet e Komunës së Prishtinës publikohen në facebook, twitter dhe instagram. | Zyra për media | | |
| 21 | Qasje e shpejtë dhe transparente e qytetarëve në shërbimet digjitale | Komuna e Prishtinës në qendër të vëmendjes e ka qytetarin dhe lehtësimin e qasjes së qytetarit në shërbimet që i ofron Komuna. Komuna i publikon në ueb-faqen zyrtare të gjitha informatat e nevojshme për qytetarë, në mënyrë që ai të pajiset me dokumente të caktuara. Janë publike: udhëzuesit, broshurat, si dhe platforma “Regjistrimi i procedurave administrative në Komunën e Prishtinës”, ku e informon qytetarin edhe për detajin më të vogël rreth pajisjes me një dokument të caktuar. | Drejtoria e Administratës | | |

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës. |
|-----|---|--|--|----------------------------------|--|
| 22 | Platforma digjitale për participim të publikut (qytetarëve) – Prishtinalme | Qytetarët të gjitha kërkesat e tyre për lagjen ku jetojnë i bëjnë në këtë platformë. Kërkesat shqyrtohen nga ana e zyrtarëve komunal. Ato kërkesa të cilat kanë vota më shumë nga qytetarët merren parasysh në hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. | Drejtoria e Administratës | | |
| 23 | Qytetari aktiv – E-inspeksioni | Aplikacion ku qytetarët i paraqesin parregullsitë dhe mosrespektimin e ligjit. | Drejtoria e Inspeksionit | | |
| 24 | Transparenca në Kulturë | Platformë për të aplikuar “online” për subvencione, si dhe përcjelljen e gjithë procesit të aplikimit | Drejtoria e Kulturës | | |